

PROGRAMI PËR PARTNERITET I GRUPIT SHQIPTAR TË BANKËS

Shtysat e Programit të SPV

Shtysa kryesore e SPV për VF11-14 është strategjia për zhvillim e Qeverisë siç artikullohet në SKZHI dhe në Dokumentin shoqërues Për Orientimin e Asistencës së Huaj (EAOD). Dokumenti i dytë, i cili është përgatitur nga Qeveria në Prill 2008, jep udhëzime për partnerët për zhvillim mbi fokusimin e asistencës për mbështetjen e SKZHI. Në mënyrë specifike, EAOD bën thirrje për një përdorim më të madh të qasjeve programatike në asistencën për zhvillim dhe një fokus të shtuar nga partnerët për zhvillim për sa i përket ujit, mjedisin, shëndetësisë dhe sektorëve të pronave. Si përcakton një rol të qartë për huadhënësit multilateral dhe sfidat e aprovimit në IDA:

“Huat multilaterale po luajnë një rol të rëndësishëm në Shqipëri. Veçanërisht në fushat që nuk marrin tradicionalisht mbështetje nga BE, si shëndetësia, arsimit dhe reforma sociale, por gjithashtu në infrastrukturë dhe burime natyrore. Aprovimi në statusin e IDA do të thotë se elementi i subvencioneve në hua tashmë është më pak se 20%. Gjithsesi, huat multilaterale janë veçanërisht të rëndësishme për Shqipërinë duke qenë se BB dhe multilateral të tjerë mund të japin ekspertizë të rëndësishme për të komplementar financimet e tyre dhe sepse shumë prej këtyre investimeve mundësojnë përfitime sociale në aspektin afatgjatë.”

EAOD përcakton fusha kyç për të cilat inkurajon partnerët që të ruajnë apo të ulin mbështetjen dhe të tjera për të cilat do të preferonte të punonte duke përdorur idealist burime vendase private apo publike. Në këtë aspekt, ky dokument kërkon të ruaj nivelin e asistencës së huaj për: (i) administrimin publik/sundimin e ligjit, por me theks më të fortë drejt drejtësisë dhe rendit publik; (ii) reformave të zhvillimit ekonomik “por me një qasje të përbashkët kombëtare e cila reflekton normat e BE [për të cilat] IPA duhet të identifikojë”; (iii) shërbimet sociale ku dokumentet i kërkojnë “Bankës Botërore të vazhdojë lidhësin e saj dhe të ndërtojë bazuar në qasjen gjithë sektoriale (QGS) që ka filluar në fushën e arsimit”; dhe (iv) infrastruktura, por me një fokus në rritje ndaj furnizimit dhe higjienës së ujit, dhe menaxhimin e lidhur mjedisor. Në infrastrukturë, prioritetet përfshijnë “plotësimin e rrjetit kombëtar dhe rural të rrugëve, sigurisë rrugore, efikasitetit të energjisë, reformës në menaxhimin e ujit dhe higjienës në nivel lokal së bashku me investime të ngjashme në pasuritë fizike, dhe institutet mjedisore për ndërtim efektive.”

Tabela 1: Nevojat dhe Orientimi për Asistencën e Huaj, sipas Sektorëve

Nevojat		Mangësitë në programacionin e donatorëve
Demokratizimi dhe sundimi i ligjit	Do të vazhdoj të kërkojë një pjesë domethënëse të investimeve publike, me një rol kritik për asistencën e huaj.	Theksi i veçantë ndaj administrimit publik është i mirëpritur, por drejtësia dhe rendi publik duhet të shfaqen më fortë në programet e donatorëve.
Zhvillimi Ekonomik	Nevoja urgjente për të vendosur institucione dhe mekanizma, që të ndiqen nga financime madhore për zhvillimin e sektorit privat, duke përfshirë zhvillimin rural dhe rajonal	Merr theksin më të fortë të të gjithë sektorëve për sa i përket programeve të donatorëve, duke sugjeruar që donatorët po përgatiten për mbështetje më të madhe, në linjë me prioritetet e SKZHI
Transporti	Prioritet kryesor dhe për të paktën katër vitet e	Mbështetje pozitive në programet e

	ardhshme, pas të cilit fokusi do të zhvendoset nga rrugët e mëdha tek siguria rrugore	donatorëve. Duhet mbështetur për disa vite të tjera, edhe pse financimi vendor do të jetë dominues.
Uji	Nevojë urgjente për të përmirësuar kapacitetin menaxhues që ka nevojë për investime të mëdha	Vëmendja në programet e donatorëve është e rëndësishme për aspektin afatshkurtër, por do duhet të rritet në aspektin afatgjatë.
Zhvillimi Social	Fokus Imediat për reformat dhe institucionet, si dhe nevojë për investime	Interesi i në dokumentet e programacionit të donatorëve është më i gjerë se sa mbështetja aktuale, çka sugjeron se mbështetja e disa donatorëve për sektorët social mund të realizohet.
Zhvillim territorial	Zgjerimi i mbështetjes për zhvillimet lokale, rurale dhe rajonale do të jetë një karakteristikë shumë domethënëse e integritit në BE	Zhvillimi rural, rajonal dhe bujqësor, dhe planifikimi urban nuk shfaqen bindshëm në dokumentet e programacionit të donatorëve dhe për to duhet të ketë më shumë fokusim .

Burimi: Shqipëria – Dokumenti Orientues për Asistencën e Huaj, Prill 2008

Qeveria i ka kërkuar së fundmi Bankës financim për mbështetjen e sfidave fiskale me të cilat përballet Shqipëria në aspektin afatshkurtër dhe afatmesëm. Veçanërisht, autoritetet kanë instruktuar ministritë e linjës për integrimin e plotë të financimeve të bankës në kuadrot buxhetore në aspektin afatmesëm dhe që këto të fundit të përfshihen brenda, në vend që të shtohen sipër, tavanit të buxhetit. Kjo kërkesë reflekton ndërgjegjësimin e plotë të autoriteteve se aprovimi i plotë i Shqipërisë vetëm për huat e BNRZH – dhe tendencën shoqëruese të partnerëve të tjerë për terma më pak koncesionar financimi – kërkon një makro menaxhim më të kujdesshëm për opsionet e tij të financimit për zhvillim. Ministria e Financës theksoi në mënyrë eksplicite se “fondet e BNRZH të marra nga BB përmes SPV janë në terma më të përshtatshëm se ato që gjenden në tregjet financiare” dhe se përfshirja brenda programit të buxhetit kombëtar jo thjeshtë do të lehtësonte planifikimin më të mirë të integruar në aspektin afatgjatë, por gjithashtu do të inkurajonte donatorët e tjerë që të ndiqnin këtë princip të Deklaratës së Parisit. Ministri gjithashtu u ka bërë thirrje të gjithë partnerëve për zhvillim që të fokusohen gjatë viteve të ardhshëm në përshejtimin e zbatimit të programit të vazhdueshëm e substancial të financuar nga donatorët në Shqipëri për të ndihmuar kufizimet fiskale ndërkohë që ruhen investimet kritike për rritjen afatgjatë dhe zvogëlimin e varfërisë.

Këshillimet e SPV u mbajtën me një rang të gjerë grupesh interesi - - ekzaktësisht, Parlamenti përfshi dhe anëtarët e opozitës, Banka e Shqipërisë, përfaqësues të sektorit privat dhe shoqërisë civile, donator si dhe me zyrtarë të qeverisë. Reagimi kryesor nga Komisioni Parlamentar i Ekonomisë dhe Financave lidhej me hartimin e kushtëzimit për mbështetjen buxhetore për të cilën Anëtarët e Komisionit u shprehën se duhej të limitohej në më pak çështje me prioritet të lartë. Për më tepër, disa anëtar sugjeruan se Banka duhej të thelloj fokusin e saj në çështjet makroekonomike (veçanërisht në mungesë të një programi të Fondit dhe të prezencës lokale) dhe të publikojë në mënyrë të rregullt rishikime analitike të performancës makroekonomike. Nevoja për një Grup të Bankës Botërore i cili është më i fokusuar dhe i konsoliduar ishte gjithashtu një temë tjetër e theksuar nga Anëtarët e Komisionit, të cilët shprehën shqetësime për nivelin e zbatimit të projekteve. Donatorët i mirëpritën përpjekjet e vazhdueshme të Bankës për t'u bërë partner me financues të tjerë, dhe e ftuan Bankën që të bashkohej në BE-Iniciativën e Donatorëve Bilateral Evropian për *ndarjen e punës*. Ata gjithashtu e shtynë Grupin e Bankës që të merrte një rol më të rëndësishëm në adresimin e ekonomisë informale dhe për të ndihmuar rritjen e kapacitetit të sektorit privat. Shoqëria civile

vazhdoi të kërkonte nga Banka që të ishte bujtëse e sa më shumë debati publik për çështje makroekonomike dhe çështje më të gjera të zhvillimit. Për më tepër, përfaqësuesit sugjeruan një fokus më ndër-sektorial për adresimin e sfidave kryesore, si p.sh. ndikimi i transportit në regjistrimet shkollore apo roli i menaxhimit të pyjeve në zonat e varfra malore.

Integrimit me axhendën e hyrjes në Evropë. Në 14 Prill, 2010 Qeveria dorëzoi përgjigjet e Shqipërisë ndaj pyetësorit pre-hyrës të KE si hapi i ardhshëm në procesin e kandidimit. Reformat që lidhen me BE priten të marrin një vëmendje më të madhe gjatë viteve të ardhshme, dhe Banka ka mundësuar mbështetje relevante aty ku ka qenë e përshtatshme. Gjithsesi, qeveria deri më tani e ka bazuar dialogun e saj me Bankën tek avantazhet konkurruese dhe krahasimore të Bankës, në vend që të përdorte ekspertizën e Bankës gjatë ndjekjes së reformave për integrim në BE. Gjithsesi, mbështetja për axhendën Evropiane të Shqipërisë pritet të bëhet një prioritet më i fortë, veçanërisht pas publikimit të rezultateve të pyetësorit pre-hyrës të BE (me shumë gjasa në fillim të 2011). Banka do t'i ndjekë këto zhvillime nga afër dhe do të jetë e përgatitur për t'u angazhuar më tej në reformat e rëndësishme të BE, veçanërisht në qeverisje, PFM, dhe çështje mirëbesimi, si dhe në fusha qendrore të programit të SPV. Ndërkohë, skuadrat e projekteve do të punojnë për t'u siguruar se janë plotësisht të familjarizuar me kërkesat e BE, dhe se do t'i integrojnë ato sa më shumë të jetë e mundur në aktivitetet huadhënëse.

Më tej, rajoni EAQ po sheh që të thellojë dhe zgjerojë partneritetin e tij me Komisionin Evropian. Dy institucione po eksplorojnë më shumë ndërveprim për programet me qasje gjithë sektoriale për vendin, por edhe për projektet rajonal, mbështetur në bashkëpunimin e suksesshëm që u pa në Komunitetin Energjetik të Evropës Jug Lindore (ECSEE) dhe në Pasqyrën e Tndore (SEETO). Në veçanti, për programin e SPV për Shqipërinë, Banka do të kërkojë në mënyrë aktive fusha për programe të përbashkëtave Komisionin, për ta mbështetur më efektivisht progresin e Shqipërisë në rrugën drejt anëtarësimit.

Vështrim i Përgjithshëm i Strategjisë për Partneritet me Vendin

Siç është përmendur dhe më parë, Shqipëria hyn në periudhën e SPV të re pasi i ka bërë ballë relativisht mirë krizës globale financiare dhe ekonomike; duke mbajtur rritje ekonomike pozitive, edhe pse shumë të reduktuar, gjatë vitit 2009 dhe me një sektor bankar të shëndosh. Duke pasur parasysh rikuperimin e ngadaltë në Evropë dhe vështirësitë në Greqi – një partner madhor ekonomik për tregtinë, investimet dhe remitancat – vitet e ardhshme kanë gjasa të jenë më pak të favorshme se ato të mëparshmet. Sfidat kryesore për të pasur sërish një rritje të lartë duke pasur parasysh këtë situatë, përfshijnë: (i) rikthimin e shpejte tek politikat e shëndetshme fiskale në aspektin afat mesëm dhe forcim i mëtejshëm i menaxhimit të shpenzimeve publike; (ii) përmirësim i zbatimit të programit tashmë të gjerë të Shqipërisë për reforma rregullatore në forcimin e konkurrueshmërisë dhe nivelet e investimit; (iii) zvogëlim i mëtejshëm i boshllëkut infrastrukturor duke ndjekur rrugë të qëndrueshme fiskale, dhe (iv) zgjerim i aksesit për sektorin privat ndaj kredive. Ndërkohë, ringritja e ngadaltë ka shumë mundësi të ndihet në kurrizin e atyre më vulnerabël çka kërkon një vëmendje të veçantë për përmirësimin e efektivitetit të sistemeve të mbrojtjes sociale dhe progresit të mbrojtur të indikatorëve social. Së fundmi, Shqipëria më në fund po ndërgjegjësohet për sfidën e saj me ndryshimet klimaterike – si vendi i dytë më vulnerabël në Evropë dhe Azi Qendrore – çka lidhet në mënyrë primare me menaxhimin e resurseve të ujit ndaj të cilave ekonomia është shumë e varur për energji dhe bujqësi.

Programi i përbashkët i Grupit të Bankës i prezantuar në këtë SPV do ta ndihmojë Shqipërinë të përballet me sfidat e sipërpërmendura, duke u fokusuar në tre objektiva strategjike:

- (i) Përshpejtim i ringritjes së rritjes ekonomike Shqiptare përmes konkurrueshmërisë së përmirësuar*** duke forcuar menaxhimin e makroekonomik dhe atë të shpenzimeve publike, duke përmirësuar rregullat për biznesin dhe duke reduktuar kostot e pajtimit, duke mbështetur bankat lokale dhe kompanitë konkurruese lokale, dhe duke përmirësuar shërbimet kryesore infrastrukturore dhe qëndrueshmërinë e tyre financiare.
- (ii) Zgjerim dhe mbështetje për përfitimet sociale në Shqipëri*** duke përmirësuar aksesin në arsim dhe shërbime shëndetësore më cilësore, dhe duke rritur efektivitetin e sistemit të mbrojtjes sociale
- (iii) Duke ulur vulnerabilitetin e Shqipërisë ndaj ndryshimeve klimaterike,*** duke përmirësuar konservimin, menaxhimin dhe përdorimin efikas të burimeve të saj ujore, dhe duke forcuar përgatitjen ndaj katastrofave.

Ky SPV vazhdon qasjen e “Grupit të Bankës Botërore”, të iniciuar gjatë CAS të përbashkët të mëparshëm për Shqipërinë, dhe synon për një program më të fokusuar dhe sinergjik. Ndërmarrjet e koordinuara të BNRZH –IFC synojnë sektorët e mëposhtëm me prioritet: (i) infrastrukturë kombëtare – energji dhe rrugë; dhe (ii) infrastrukturë bashkiake, kryesisht furnizimin me ujë dhe menaxhimin e mbeturinave inerte, dhe (iii) mjedisi i biznesit.

Për më tepër, programi i SPV gjithashtu reflekton një thellim të fokusit sub-rajonal në Ballkanin Perëndimor dhe Evropën Jug Lindore. Shqipëria ka përfituar dhe po përfiton nga projektet rajonale të Ndihmës në Transport dhe Tregti në programin e Evropës Jug Lindore dhe të Komunitetit të Energjisë në Evropën Jug-Lindore. Gjatë kësaj periudhe SPV, Banka pret të zgjerojë dhe të zhvillojë më tej Ndihmën për Sigurim ndaj Rreziqeve të Katastrofave, për të cilën Shqipëria është një nga anëtarët themelues. Për më tepër, Shqipëria do të vazhdojë të përfitojë nga një lëvizje drejt punës ekonomike dhe sektoriale rajonale (ESW) si një mënyrë për të përdorur resurset e mundshme të Bankës Botërore për të rritur efikasitetin e krijimit të njohurive. Fushat kyçe në këtë aspekt përfshijnë analizën e varfërisë, politikat sociale, transportin, ujin, ndryshimet e klimës dhe sektorin financiar. Në vijim, mund të shtohen prioritetet të reja, bazuar në kërkesën e klientit dhe në shtrimin e çështjes/sectorit në një qasje rajonale më shumë se sa në të gjithë vendin.

Programi i SPV do të vazhdojë që gjithashtu të mbështesë përmirësimet në qeverise në Shqipëri duke rafinuar Filtrin e Qeverisjes (i zhvilluar fillimisht gjatë VF06-09 CAS) për t’u fokusuar në një set të qartë kërkesash për projektet e financuara nga Banka që synojnë të thellojnë ndikimin ndaj menaxhimit të shpenzimeve publike, efikasitetin e administratës, praktikatat e shpalljes publike dhe mirëbesues në ministritë qeveritare.

Qasja kryesore e SPV do të jetë fokusimi drejt përmirësimit dhe përshpejtitimit të implementimit të portofolit të gjerë aktual të projekteve të financuara nga Banka, të cilët po adresojnë tashmë sfidat kryesore të vendit, në një numër të reduktuar të sektorëve kritik. Ky fokus ndaj portofolit ekzistues është i nevojshëm për të shpërndarë rezultatet e pritura dhe ndikim në zhvillim, ndërkohë që përmirësohet rritmi i transferimit të burimeve tek Qeveria teksa ajo përballet me shtrëngesa të reja fiskale. Një pjesë e rëndësishme e kësaj qasje fillestare do të jetë integrimi i mëtejshëm i programeve të financuar nga Banka në buxhetin dhe kuadrin

administrativ të qeverisë në mënyrë që të përftoheshin përfitimet e shtuara në terma të menaxhimit të shpenzimeve publike, dhe kapaciteteve mirëbesues dhe administrative.

Kjo strategji huadhënie gjithashtu synon të plotësojë konsolidimin e portofolit të investimeve në 10-12 veprimtari deri në VF14 (nga 21 projekte në VF04). Strategjia e konsolidimit reflekton kërkesën e Qeverisë që Banka të fokusohet në më pak projekte por në projekte më të mëdha dhe të vazhdojë të mobilizojë programe të koordinuara gjerësisht nga donatorët në fushat kyç të zhvillimit. Lëvizja për të konsoliduar portofolin gjithashtu reflekton nevojën për një përdorim më efikas të burimeve të Bankës dhe aftësive menaxheriale të Qeverisë për të mbështetur programin Shqiptar, dhe për të lehtësuar resurset e brendshme të Bankës për të kryer më shumë punë analitike dhe këshillimore me Qeverinë për sfidat e ardhshme të Shqipërisë. Ndërkohë Banka dhe IFC do të mbështesin reformën rregullatore e cila synon të përmirësojë perspektivat për rritjen e financimit e sektorit privat për pengesat kryesore infrastrukturore.

Tabela 2: Programi i Investimeve IDA/BNRZH * VF11-14

Përsheptim i Ringritjes së Rritjes Ekonomike përmes Konkurrueshmërisë		Zgjerim dhe Mbështetje për Përfitimet Sociale		Reduktim i Vulnerabilitetit ndaj Ndryshimeve Klimaterike	
Projekte investimi në vazhdimësi (data e mbylljes)					
Gjenerim i Sektorit Energjisë	VF11	Arsimi, Epër. & Barazia	VF12	Zhv. Burimeve Natyr.	VF11
Reforma e Amb. Biznesit	VF11	Shpërndarja e Shrb. Soc.	VF13	Grip i Shendëve	VF11
Transporti	VF11	Mod Sistemit Shëndetësor	VF13	Mnxh Intg i Zonave Breg.	VF13
Adm. & Mnxh. i Tokës	VF12			Ekosistemi i Liq. Shkodrës	VF13
ECSEE APL2 Transmission	VF12			Lehtësim i Rreziqeve të	VF13
Sistem i Intg. Plan.MDTF	VF12			Katastrofave	
Rrugët Sekondare & Lokale	VF13				
ECSEE APL5 Sig. e Digave	VF14				
Projekte të planifikuara investimi (data e shpërndarjes)					
Burimet Ujore & Vadiqe	VF12	Inv Asistenca Sociale	VF12	Furnizimi Bashkiak meUjë	VF11
Mirëmb. e Rrugëve&Siguria	VF13	Arsimi	VF14	Shërbimet Mjedisore	VF13
Reforma e Sektorit Publik	VF14	Sektori Shëndetësor	VF14		

* Programi do të përfshijë gjithashtu DPL vjetore dhe PGR të vazhdueshme.

Objektiva dhe Rezultate Strategjike

Objektiva e SPV është të mbështesë zhvillimin e Shqipërisë përmes tre objektivave strategjik dhe të vazhdojë të përdorë Filtrin e Qeverisjes ndër-sektorial. Objektivat strategjik përfshijnë: (i) përsheptimin e ringritjes së Shqipërisë në nivele të larta të rritjes ekonomike në Evropën e pas krizës; (ii) zgjerim dhe mbështetje për përfitimet sociale të Shqipërisë; (iii) reduktim të vulnerabilitetit të Shqipërisë ndaj ndryshimeve të klimës. Detajet mbi natyrën e secilës prej objektivave strategjike, duke përfshirë instrumentet parësor në vazhdim dhe ato të propozuar, përshkruhen më poshtë.

Objektiva Strategjike 1: Përsheptim i rimëkëmbjes së rritjes ekonomike të Shqipërisë përmes përmirësimit të konkurrueshmërisë

(i) *Menaxhim makroekonomik i shëndoshë dhe përmirësim i menaxhimit të shpenzimeve publike*
(ii) *Përmirësim i rregullave të biznesit dhe ulje e kostove të pajtimit për sektorin privat*

(iii) *Shërbime infrastrukturore të përmirësuara, dhe më të qëndrueshme financiarisht, në rrugë, energji dhe vaditje.*

(iv) *Banka dhe institucione mikrofinanciare më të forta dhe mbështetje për kompanitë lokale me konkurrencë të lartë*

Menaxhim makroekonomik i shëndoshë dhe përmirësim i menaxhimit të shpenzimeve publike

Banka do të mbështesë përpjekjet e Qeverisë për të forcuar performancën makro, veçanërisht atë fiskale, dhe menaxhimin shpenzimeve publike. Mbështetja e Bankës do të mundësohet fillimisht përmes një serie huash të bazuara në politika së bashku me një rang shërbimesh analitike dhe këshillimore të reja dhe të vazhdueshme, pasuar nga një projekt i planifikuar i *Reforme të Sektorit Publik* në VF14. Fokusi kryesor i kësaj mbështetje do të jetë ndihma ndaj Shqipërisë: (a) për të përmirësuar besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e politikave fiskale; (b) për të plotësuar kuadrin për mbrojtjen e stabilitetit të sektorit financiar; (c) për të kryer përmirësime të mëtejshme në menaxhimin e shpenzimeve publike dhe performancën e mirëbesimit; dhe (d) për të thelluar mundësitë për përfshirjen e qytetarëve në proceset publike të vendimmarrjes.

Huate e propozuara të *Shërbimeve Sociale* (VF11) dhe *Rritjes* (VF12-VF14) *Huat për Politikën e Zhvillimit* (DPL) prej 25 milion \$ secila do të adresojnë, ndër të tjera, reforma në politikën fiskale dhe shpenzime publike, duke përfshirë përmirësimin e efikasitetit të shpenzimeve sociale (DPL Shërbimet Sociale) dhe vendosjen e një rregulli fiskal apo një mase të ngjashme për të shtyrë politikën e kujdesshme fiskale (DPL-te e Rritjes).

Përpjekjet për të përmirësuar besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e politikave fiskale do të karakterizohen nga: (a) angazhimi i rifreskuar i Bankës në një dialog transparent dhe publik për politikën fiskale dhe (b) intensifikim i përfshirjes së Bankës në monitorimin dhe analizën e modeleve të shpenzimeve sektoriale dhe rezultateve si pjesë e menaxhimit të portofolit të saj të projekteve. E para do të fillojë me shpërndarjen e *Memorandumit Ekonomik për Vendlindjen (CEM)* të përfunduar kohët e fundit, e pasuar nga publikimi prej Bankës i pasqyrave tre mujore ekonomike që analizojnë zhvillimet makroekonomike. Këto raporte do të jenë të rëndësishme duke pasur parasysh mungesën e programit të FMN, por edhe në rast se ky i fundit adaptohet raportet mund të vazhdojnë të mbështesin debate më të detajuara mbi politikën e shpenzimeve publike – si në sektorin sektorial ashtu dhe në atë strukturor. Analizat sektoriale do të i detyronin skuadrat makroekonomike dhe sektoriale të Bankës të ndërmerren disa analiza për shpenzimet publike dhe institucionet si pjesë e përgatitjes për projektin të mbikëqyrjes së ministrive kryesore. Këto analiza do të mbështesnin integrimin edhe më të madh të projekteve të financuara nga Banka gjatë Rishikimit Afatmesëm të Buxhetit (RAMB) si dhe do të mundësonin bazë të mëtejshme analitike gjatë rishikimit vjetor të buxhetit nga Qeveria.

Përpjekjet për të përmirësuar sistemin e menaxhimit të shpenzimeve publike do të bazoheshin origjinalisht në *Fondin e Mirëbesimit prej Disa Donatorëve për Sistemin e Integruar të Planifikimit (MDTF)*, i cili i ka mundësuar Shqipërisë që të përmirësojë më tej proceset e saj MTBP që lidhen me strategjinë kombëtare. Ky grant gjithashtu mbështet: (i) sistemin e

shpërndarjes së Thesarit; (ii) zhvillim për një Sistem Informimi të Menaxhimit Financiar për Shqipërinë (AMFIS) që të lidh monitorimin e rezultateve të zhvillimit me zbatimin e buxhetit; dhe potencialisht (iii) ndërtim kapacitetesh për Institutin e Statistikave Kombëtare, në veçanti, për prodhimin e llogarive kombëtare. Puna analitike që do të nxirrte në pah nevojat për zhvillim dhe ato të së ardhmes përfshin dhe një raport të ri *Përgjegjshmërinë e Shërbimeve Publike dhe Financiare* (PEFA) gjatë VF12¹ dhe rifreskime të Raportit për Mbikëqyrjen e Standardeve dhe Kodeve (ROSCs) për transparencë Fiskale dhe Kuadrin e Vlerësimit të Kualitetit të të Dhënave, në lidhje me FMN.

Për sa i përket shpenzimeve publike dhe qeverisjes Shqipëria ka bërë progres në aspektin e prokurimeve publike dhe menaxhimit financiar të huave përmes përdorimit të disa sistemeve kombëtare nga Banka. Mbështetje e mëtejshme do të mundësohet përmes grantit të *Facilitetit për Partneritet me Qeverinë (GPF)* për zhvillim të mëtejshëm të sistemeve të prokurimeve dhe menaxhimit financiar (shih Tabela 3, më poshtë). Shpërndarja e sistemit të Thesarit dhe AFMIS do të luajnë një rol të rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve për përmirësimin e raportimeve buxhetore, kontabilitetit të parasë dhe menaxhim financiar, ndërkohë që reformat e lidhura me auditin e brendshëm dhe kontrollin mbështeten plotësisht nën instrumentin e BE për programin e Para-Pranimin.

Përmirësimi i rregullave të biznesit dhe ulja e kostove të pajtimit për sektorin privat

Shqipëria ka marrë hapa madhor për të përmirësuar kuadrin e investimeve private përmes një programi të gjerë të reformave rregullatore, por mbeten ende boshllëqe domethënëse midis rregullave të reja dhe implementimit të tyre në praktikë siç evidentohet nga ‘taksa e kohës’ e cila mbetet vazhdueshmërisht e lartë sipas raporteve të fundit BEEPS dhe ICA. ***Fokusi strategjik i Grupit të Bankës gjatë kësaj SPV do të jetë të plotësojë reformat aktuale që lidhen me administrimin e tokës dhe inspektimin e bizneseve që synojnë të ulin ‘taksën e kohës’, dhe të vendosi një sistem modern për përgatitje më të mirë të reformave rregullatore përpara adoptimit të tyre.***

*Projekti aktual mbi Reformën e Ambinetit të Biznesit dhe Forcimit Institucional (BERIS) po mbështet prezantimin e një Vlerësimi për Ndikimin e Aspektit Rregullator (RIA) dhe reformën e kuadrin Shqiptar për inspektime të biznesit, ndërkohë që Projekti për Administrimin dhe Menaxhimin e Tokës (LAMP) po financon modernizimin e Zyrës së të Drejtave të Pronës së Patundshme dhe regjistrimin e 75 përqind të pronave urbane të paregjistruara. Aktivitetet kryesore plotësohen nga një *Iniciativë për Reformë të Dooing Business për Evropën Jug Lindor*, dhe nga *Projekti i IFC për Thjeshtëzimin e Taksa, Programi për Konkurrueshmërinë në Nivel Kombëtar dhe Programin e Logjistikës së Tregtisë.**

Programi i SPV do të vazhdojë gjithashtu implementimin të një sërë programesh më të vogla që synojnë të forcojnë kapacitetet e sektorit privat për të plotësuar kërkesat e BE dhe ato ndërkombëtare. Këtu përfshihen:

- *Programi Rajonal për Reformën në Kontabilitet dhe Standardet Institucionale (REPARIS) Projekti i Zgjeruar i Raportimit për Korporatën që synon të forcojë*

¹ PEFA e fundit për Shqipërinë u përgatit në 2006.

raportimin e sektorit financiar të korporatave në linjë me kërkesat e BE dhe ato ndërkombëtare; dhe i komplementuar nga *Programi i IFC për Qeverisjen e Korporatave* i cili mundëson asistencë direkte për ndërmarrjet lokale për të përmirësuar marrëveshjet e tyre të qeverisëse.;

- *Projekti BERIS* i cili gjithashtu në mbështetje të një përmirësimi në infrastrukturën e metrologjisë dhe standardeve teknike, dhe komplementohet nga *një program i IFC mbi Standardet Ndërkombëtare dhe Rregullat Teknike* i cili mundëson asistencë direkte për bizneset e vogla teksa plotësojnë standardet teknike;
- Një fond mirëbesimi i *Iniciativës për Transparencë për Industrinë Nxjerrëse* po mbështet kuadrin pjesëmarrës të njohur në rang ndërkombëtar për transparencë të të ardhurave në sektorin e minierave, mbështetur nga investimet e IFC në sektorin në rritje të minierave; dhe
- Një Fond Institucional Zhvillimi (IDF) që mbështet implementimin e Konventës së OKB në AARHUS mbi transparencën dhe pjesëmarrjen në leje-dhënie dhe vendimmarrjen mjedisore.

Shërbime Infrastrukturore të përmirësuara, dhe më të qëndrueshme financiarisht, në rrugë, energji, dhe vaditje

Duke pasur parasysh shtrëngimet fiskale dhe resurset e limituara të Bankës, ***strategjia e SPV për këtë objektivë është që (a) të konsolidojë reformat aktuale dhe të plotësojë investimet e vazhdueshme në sektorët e energjisë dhe rrugëve, ndërkohë që punohet për të mbledhur gradualisht mekanizma financues të rinj dhe privat, aty ku është e mundur, dhe (b) të vazhdojë investimet në sistemin e vaditjes.*** Kërkesa e qeverisë për një zhvendosje graduale drejt shpërndarjes bashkiake të ujit do të adresohet gjatë Objektivës Strategjike 3 për uljen e vulnerabilitetit të Shqipërisë ndaj ndryshimeve klimaterike përmes përmirësimit të menaxhimit, konservimit dhe përdorimit më efikas të burimeve ujore.

Në **sektorin e energjisë**, SPV do të fokusohet tek konsolidimi i rezultateve nga portofoli i gjerë aktual i cili përfshinë katër projekte të Bankës dhe dy programe të IFC. Në krahun e Bankës, (i) *Projekti për Gjenerimin dhe Rikonstruktimin e Sektorit* pritet të arrijë, shumë shpejt, përmes veprimtarive komerciale të Termocentralit Energjetik të Vlorës një shtesë prodhimi energjie prej 700 GWh në kapacitetin e diversifikuar të prodhimit të elektricitetit në Shqipëri; (ii) *Programi i Huas së Adaptuar ECSEE (APL) 2 Projekti i Transmisionit* po financon zëvendësimin e tre nënstacioneve të vjetra çka është kritike për përmirësimin e kualitetit, për qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e pjesës më të madhe të sistemit të transmisionit të energjisë dhe për ndërtimin e kapaciteteve në Operatorin e sapo veçuar të Sistemit të Transmetimit; dhe (iii) *ECSEE APL 5 Projekti për Sigurinë e Digave* po mbështet përmirësimet e efikasitetit në kaskadën më të madhe të hidro-energjisë në Shqipëri, dhe po ndihmon për shtimin e investimeve private në hidrocentrale. Për më tepër, në addition, *Garancia ndaj Rrezikut të Pjesshëm* e aprovuar rishtazi për kompaninë e privatizuar të shpërndarjes së elektricitetit mbetet kritike për të siguruar stabilitet rregullator në këtë sektor dhe lehtësimin e investime kryesore nga operatori i ri.

Ndërkohë IFC do të vazhdojë *Iniciativën e Granitit të Performancës për Efikasitetin e Energjisë Rezidenciale* që synon të mundësojë deri në 7,000 mikro-kredi me vlerë rreth 28 milion US \$ për përmirësimet e efikasitetit të energjisë nga familjarët me një synim për të kursyer 24,500 megawatt-orë energji dhe deri në 30,000 ton gaze ‘Greenhouse’ (GHG) të shmangura deri më

VF12. IFC gjithashtu po ndërmerr një *Program për Energjinë e Rinovueshme për Hidrocentralet e Vogla* i cili synon të përmirësojë kuadrin ekzistues rregullator, të mundësojë zhvillimin e kapaciteteve për investitorët dhe të punojë me institucione të zgjedhura financiare për të forcuar mbështetjen me financime për hidrocentralet e vogla. Mbeshtetur edhe ne privatizimet e fundit të suksesshme në këtë sektor, aty ku të jete e mundur, IFC do të konsiderojë mbështetje për kompanitë private të shpërndarjes dhe prodhimit të energjisë.

Në **sektorin e transportit**, SPV do të fokusohet në perfundimin e dy projekteve ekzistues: projekti i *Projektit të Transportit*, i cili po financon ndërtimin e segmentit të ri Milot-Rrëshen në rrugën për Kosovë dhe *Projektin e Rrugëve Dytësore dhe Lokale* i cili përforcon Programin ekzistues të Qeverisë prej 430 milion \$ për Rrugët Dytësore dhe Tretësore. Pas kësaj, Grupi i Bankës do të mbështesë zhvillimin institucional dhe ndërtimin e kapaciteteve për mirëmbajtjen e rrjetit të rrugëve kombëtare. Gjithashtu, Projekti Ekzistues i Transportit po piloton përdorimin e kontratave të mirëmbajtjes së bazuara në performancë të cilat do të vendosin bazat për *Projektin të Mirëmbajtjes dhe Sigurisë Rrugore* të planifikuar për VF13 për të mbështetur krijimin e një programi të koordinuar nga donatorët për plotësimin e rehabilitimit dhe vendosjen e mirëmbajtjes rutinë për rrjetin e rrugëve kombëtare. Me të njëjtën mendësi, IFC ka planifikuar shërbime këshillimore *Për një Partneritet Publik e Privat* për plotësimin, mirëmbajtjen dhe veprimtarinë e rrugës së re për Morinë në kufirin me Kosovën. IFC do të vazhdojë të nxisë qeverinë për të terhequr investime në sektorin privat në porte përmes PPP-ve dhe koncesioneve aty ku të jete e mundur. IFC do të mbështesë financime të sektorit privat për projekte në sektorin e transportit pas privatizimeve.

Projekti i planifikuar i Burimeve Ujore dhe Vadijes (VF11) do të bazohet në mësimet e investimeve të mëparshme në vadije, ku akoma një e treta e rrjetit kombëtar mbetet në nevojë për t'u rehabilituar, për të dresuar gjithashtu sigurinë në rrjedhat e sipërme dhe efikasitetin e rezervuarëve vaditës, për të prezantuar mekanizma më efikas për shpërndarjen e ujit dhe për të konsoliduar reformat e fundit në menaxhimin e sistemit të vadijes dhe rikuperimin e kostos.

Mbështetja e bankave dhe kompanive konkurruese

Duke pasur parasysh krizën globale financiare, IFC do të rrisë mbështetjen e saj për **sektorin bankar** me një fokus drejt zgjerimit të aksesit për financat, veçanërisht për MSME. IFC do të mundësojë një shumëllojshmëri produktesh të adaptuara sipas nevojave të bankave lokale duke përfshirë linjat e kredisë, produkt me garanci të pjesshme, dhe efikasitet energjie dhe produkte të energjisë së rinovueshme. Nëse është e nevojshme, IFC do të konsiderojë mbështetjen për të forcuar kapitalizmin e bankave për të lehtësuar aktivitetin e tyre huadhënës ndaj sektorit real. Për më tepër, IFC do të kontribuojë për forcimin e institucioneve të mikro-financës, duke adresuar mos-barazinë ekonomike midis zhvillimit urban dhe atij rural/semi-urban.

Bankat janë treguara më agresive ndaj riskut dhe vendi është përballur me një ngadalësim të kredi-dhënies së bankave ndaj kompanive lokale. Në këto rrethana, një nga sfidat e IFC në vend është lehtësimi i pjesshëm i ndikimit të krizës duke mundësuar produkte të përshtatshme për kreditimin ndaj kompanive lokale. Duke qenë se shumica e kompanive të sektorit real janë MSMEs, IFC do të mundësojë mbështetjen e saj kryesisht përmes sektorit bankar. IFC do të kërkojë të zgjerojë financimet e saj për të përmirësuar konkurrueshmërinë e kompanive lokale në sektorët që mund të konkurrojnë me sukses falë eksporteve të tyre në tregjet rajonale. Për më tepër,

IFC do të mbështesë kompanitë e sukseshme rajonale të cilat duan të zgjerojnë veprimtaritë e tyre në Shqipëri.

Objektiva Strategjike 2: Zgjerim dhe mbështetje për përfitimet sociale të Shqipërisë

- (i) *Më shumë akses ndaj arsimit, veçanërisht arsimit sekondar dhe atij të mesëm, dhe përmirësim i kualitetit në të gjithë nivelet;*
- (ii) *Akses i përmirësuar ndaj kujdesit primar shëndetësor me kualitet dhe shpenzim më efikas për kujdesin shëndetësor publik*
- (iii) *Përmirësim i orientimit dhe efikasitetit të sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri;*

Shqipëria ka bërë hapa të suksesshëm për uljen e varfërisë absolute si në zonat rurale dhe në ato urbane. Gjithsesi rezultatet e fundit tregojnë se ka zona të dala rishtazi të varfërisë së vazhdueshme. Për më tepër, si pasojë e ringritjes, që me shumë gjasa do të jetë e ngadaltë, të nivelit të rritjes ekonomike, ekzistojnë rreziqe se sukseset e fundit për sa i përket varfërisë mund të pushojnë. SPV e re përfshin një angazhim të vazhduar për të zgjeruar aksesin ndaj arsimit më cilësor (në veçanti në nivelin sekondar dhe atë të mesëm, ku shifrat e regjistrimit për Shqipërinë janë në mënyrë domethënëse më të vogla se të standardeve rajonale) dhe të shërbimeve shëndetësore (ku rezultatet e Shqipërisë gjithashtu mbeten pas atyre të fqinjëve dhe të rajonit). SPV gjithashtu fokuson edhe një herë vëmendjen tek efektiviteti i sistemit Shqiptar i mbrojtjes sociale, ku ka mundësi përmirësimi të orientimit dhe administrimit.

Akses më i zgjeruar ndaj edukimit, veçanërisht ndaj arsimit tetëvjeçar dhe atij të mesëm, dhe kualitet i përmirësuar në të gjithë nivelet

Programi i SPV do të vazhdojë të mbështesë përmirësimet në arsim dhe zhvillimin e aftësive përmes *Projektit Ekzistues për Cilësinë dhe Barazinë e Arsimit* si pjesë e programit të parë me qasje të gjerë sektoriale në Shqipëri. Programi mbështet përmirësimet në kualitetin e arsimit tetëvjeçar çka synon të rrisë regjistrimet, të reformojë menaxhimin dhe financimin e arsimit të mesëm, dhe të forcojë kapacitetin e përgjithshëm menaxhues të të gjithë sistemit arsimor. Përmirësimet e kualitetit priten të dalin nga përpjekjet për të: (i) përmirësuar menaxhimin e shkollave përmes trajnimit, vendosjen e bordeve të shkollave dhe një programi për grante për shkollat; (ii) të ndërtojë godina të reja dhe të zgjerojë godina ekzistuese të shkollave për të ulur mbipopullimin; (iii) të prezantoj kurikula dhe libra shkollor të rinj, laborator, kompjuter dhe akses ndaj internetit; dhe (iv) të përmirësojë trajnimin, licencimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve. Duke pasur parasysh rëndësinë e nevojave që duhen adresuar dhe kërkesën e shprehur të Qeverisë ndaj Bankës për të vazhduar angazhimin e saj në këtë sektor social, një vazhdim i *Projektit të Edukimit* planifikohet për VF14. Gjithsesi, qëllimi i këtij projekti pritet të rafinohet gjatë viteve të ardhshme, dhe rezultatet e tij priten të realizohen gjatë në SPV të ardhshëm.

Akses i përmirësuar ndaj kujdesit primar shëndetësor me kualitet dhe shpenzim më efikas për kujdesin shëndetësor publik

Banka po vazhdon të mbështesë reformat kyçe në sektorin e kujdesit shëndetësor i cili synon të rrisë aksesin ndaj shërbimeve të kujdesit primar shëndetësor me kualitet, veçanërisht midis të varfërve, dhe të përmirësojë efikasitetin e shpenzimeve publike për kujdesin shëndetësor. Gjatë kësaj SPV, Banka do të vazhdojë të mbështesë reformat ekzistuese në sektorin e kujdesit

shëndetësor përmes *Projektit ekzistues të Modernizimit të Sektorit Shëndetësor* duke përfshirë: (i) reformimin e dhënies së shërbimit primar shëndetësor dhe financimit, edhe duke prezantuar një Paketë për Përfitimet Bazë dhe regjistrim universal me ofruesit e shërbimit shëndetësor për familjet; (ii) përmirësim i kualitetit të shërbimeve primare të shëndetit përmes një programi ritrajnimi dhe ripajisje ekstensive, pajisje për ofruesit e shërbimit primar të kujdesit shëndetësor; (iii) përmirësim i incentivave për më shumë efikasitet përmes kontraktimit të bazuar tek performanca dhe incentivat; dhe (iv) forcim i qeverisjes spitalore dhe menaxhimit. Duke pasur parasysh axhendën e gjerë dhe të papërfunduar në këtë fushë, planifikohet një vazhdim i *Projektit të Sektorit Shëndetësor* për VF14. Rezultatet priten të publikohen gjatë SPV të ardhshme.

Përmirësim i orientimit dhe efikasitetit në sistemin shqiptar të mbrojtjes sociale

SPV do të mbështesë përmirësimet e vazhdueshme në mbrojtjen sociale përmes *Projektit ekzistues për Shpërndarjen e Shërbimeve Sociale*, i cili u zgjerua dhe u ristrukturua për të vendosur një sistem informacioni, për të ndërmarrë përmirësime administrative dhe për të ndërtuar kapacitetet për reformën e sistemit të pensioneve; dhe punës së vazhdueshme analitike nën *Programin e Analizës dhe Këshillimit për Varfërinë* dhe *Programit të ri të PNUD për Qeverisjen Ekonomike të Shërbimeve Komunale* i cili po mbështet rishikimin dhe rivlerësimin e mekanizmave të mbrojtjes sociale për tarifën e elektricitetit dhe ujit.

Gjithsesi, fokusi kryesor i programit të SPV do të vendoset në dy veprimtari të parashikuara, një *Hua për Politikën e Zhvillimit të Shërbimeve Sociale* (VF11) i cili do të ndiqet nga një *Projekt i Investimeve për Asistencën Sociale* (VF12) i cili do të synonte të konsolidonte reformat në orientimin dhe administrimin e përfitimeve të asistencës sociale, mbështetur nga DPL, dhe përmirësime të konsoliduara në aftësinë e Shqipërisë si një vend me të ardhura të mesme që të mbrojë më të varfrit dhe ata më vulnerabël. Reformat e propozuara përfshijnë: (i) rishikim i kritereve të pranueshmërisë dhe mekanizmave orientues për asistencën kryesore sociale dhe programet e përfitimeve për paaftësinë; si dhe (ii) rritja e transparencës dhe efikasitetit në shpërndarjen e burimeve të asistencës sociale.

Objektiva Strategjike 3: Ulja e Vulnerabilitetit të Shqipërisë ndaj ndryshimeve klimatike

- (i) Përmirësim i konservimit, menaxhimit dhe përdorimit efikas të resurseve shqiptare të ujit***
- (ii) Ulje e vulnerabilitetit ndaj katastrofave natyrore dhe atyre të shkaktuara nga dora e njeriut***

Përmirësim i konservimit, menaxhimit dhe përdorimit efikas të resurseve ujore në Shqipëri

Programi i SPV do të mbështesë Shqipërinë në përballjen me sfidat e ndryshimit të klimës duke përmirësuar konservimin, menaxhimin dhe përdorimin efikas të burimeve të ujit. Strategjia fokusohet tek ndërtimi i institucioneve dhe vendosjen e investimeve për të përmirësuar efikasitetin e burimeve ujore përmes portofolit ekzistues të pesë projekteve investuese, ndërkohë që inkuorohen tre investime të reja në fushat e menaxhimit të integruar të resurseve të ujit, furnizimit bashkiak me ujë dhe higjienizimi, dhe shërbimet mjedisore.

Portofoli aktual përfshin: (i) *Projektin e Zhvillimit të Burimeve Natyrore* i cili mbështet planifikim të konservimit të bazuar në komunitet për pyje, kullota dhe ujëmbledhës të vegjël dhe investime në mbi 230 komunitete të zonave të thella dhe malore ku mbizotëron erozioni; dhe po piloton menaxhimin e integruar të tre nga shtatë ujëndarëseve Shqiptare; (ii) një *Fond Mirëbesimi për Rigjenerimin Natyral të Bio-Karbonit* i cili gjithashtu po piloton blerjen e parë të karbonit të marrë nga rigjenerimi natyral që mund të ndihmojë degradimin e tokave, të reduktojë erozionin e tokës, dhe të përmirësoj kualitetin e ujit; (iii) *Projekti për Menaxhimin dhe Pastrimin e Zonave Bregdetare të Integruara (ICZMCP)* i cili mbështet infrastrukturën mjedisore përgjatë bregut jugor, duke përfshirë dhe rehabilitimin e ndotjes në një zonë ku më parë vepronte një fabrikë kimike, përmirësime të furnizimit dhe higjienës së ujit në dy bashki të bregut, ndërtim të një ‘landfilli’ për mbetjet inerte dhe zhvillimin e një plani menaxhimi për zonen më të rëndësishme Ramsar² në Shqipëri; (iv) *Projekti i përbashkët Shqiptaro-Malazez i Facilitetit Botëror të Mjedisit (GEF) për Menaxhimin e Integruar të Ekosistemit të Liqenit të Shkodrës*, i cili po vendos një kuadër menaxhues bilateral për këtë burim të përbashkët uji; dhe (v) duke vazhduar eksperiencën e suksesshme të programit të riciklimit, *Shërbimet e propozuara këshillimore të IFC për pjesëmarrjen private në menaxhimin e mbetjeve të ngurta* e plotësuar ku të jete e mundur edhe financime koncesionare apo financime direkte të bashkive për zhvillimin e landfilleve sanitare rajonale në përputhje me legjislacionin e ri kombëtar dhe Direktivat e BE..

Dy projekte të reja planifikohen ta zgjerojnë këtë axhendë, gjatë SPV. I pari: *Projekti i Reformës dhe Investimeve për Shpërndarjen e Ujit nga Bashkia* (VF11) u ndërtua mbi eksperiencën e mëparshme të Bankës në sektorin e ujit/ujërave të zeza dhe i përgjigjet thirrjes së Qeverisë për shtimin e mbështetjes së donatorëve në këtë fushë. Projekti do të përbëjë kontributin kryesor të Bankës për një program sektorial në rang donatorësh që po përgatitet nga Qeveria (në bashkëpunim me KFW/GTZ, Korporatën Austriake për Zhvillim dhe Bankën) dhe do të fokusohet në reformën e politikave që do të percaktohet se bashku me qeverinë si për nivelin kombëtar ashtu dhe për atë lokal për një program menaxhimi në sektorin e ujit për të lehtësuar investimet bashkiake nga një sërë partnerësh donatore. Për më tepër, projekti ka shumë gjasa të mbështesë përmirësimet, dhe mundësisht pjesëmarrjen private në një nga dy sistemet më të mëdha bashkiake të ujit në Shqipëri. Ndërkohë IFC po kërkon në mënyrë aktive të mbështesë përmes shërbimeve këshillimore, pjesëmarrjes private në shërbimet komunale aty ku është e pranueshme. Projekti i propozuar *i Shërbimeve Mjedisore* (VF13) do të jetë një vazhdimësi e *Projekteve të Zhvillimit të Resurseve Natyrore dhe Bio-Karbonit* dhe do të synojë të adresojë më tej erozionin në rrjedhat e sipërme dhe çështje të tjera të degradimit që ndikojnë në qëndrueshmërinë e Shqipërisë. Për më tepër, ky projekt do të jetë gjithashtu një mënyrë për të mbledhur burime të jashtme private dhe publike drejt përpjekjeve Shqiptare për të menaxhuar dhe për t’u adaptuar me ndryshimet e klimës.

Së fundmi, *Projekti i Menaxhimit të Ujit dhe Vaditjes* (VF12) i përshkruar më sipër, është kryesisht pjesë e axhendës së infrastrukturës (shih paragrafi 0) por do t’i shërbejë gjithashtu kësaj objektivë për të forcuar kuadrin menaxhues të burimeve ujore të Shqipërisë.

² Konventa “Ramsar” për Tokat e Lagëta është një traktat ndërqeveritar i cili përfaqëson angazhimet për të mbrojtur karakterin ekologjik të Tokave të Lagura me Rëndësi Ndërkombëtare.

Ulje e vulnerabilitetit ndaj katastrofave natyrore dhe atyre të kryera nga dora e njeriut

Banka do të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për të forcuar përgatitjen ndaj katastrofave, duke u fokusuar tek implementimi i dy projekteve ekzistues dhe përbërësit për urgjencat të një projekti tjetër i cili është ristrukturuar së fundmi pas reagimit ndaj përmbytjeve të Janarit. Në kuadër të *Projektit për Lehtësimin dhe Adaptimin e Rreziqeve*, Banka po kontribuon për përmirësimin e strategjive Shqiptare të përgjigjes ndaj katastrofave, duke përmirësuar shërbimin e parashikimit të motit, duke rishikuar kodet e ndërtimit që të përputhen me kërkesat e BE për rreziqet sizmike, dhe duke vendosur Facilitetin e Evropës Juglindore për Rrezikun e Katastrofave i cili do të promovojë produkte për parandalimin e katastrofave dhe për sigurimin ndaj rreziqeve atmosferike në tregjet sub-rajonale. Banka gjithashtu do të plotësojë mbështetjen ekzistuese në kuadër të *Projektit për Përgatitjen dhe Reagimin ndaj Gripit të Shpendëve dhe Pandemisë Njerëzore*, dhe do të plotësojë investimet për të riparuar dhe përmirësuar mbrojtjen ndaj përmbytjeve dhe objekte infrastrukture të tjera në veri të Shqipërisë në kuadër të *Projektit të Ristrukturuar të Administrimit dhe Menaxhimit të Tokës*.

Filtri Qeverisës v2.0

Gjatë SPV të mëparshëm, Shqipëria prezantoi një Filtër Qeverisës i cili synonte të qendëronte një fokus drejt katër fushave kyçe të qeverisjes³ në secilën prej ndërhyrjeve të Bankës. Filtri ishte instrumental në mbajtjen e fokusit tek qeverisja përgjatë portofolit dhe në hartimin e secilit prej projekteve të reja. Si për të balancuar, kontributi i projekteve për krijimin e mekanizmave më të fortë institucional në sektorët individual ishte substancial, duke përfshirë për shembull, proceset transparente për përzgjedhjen e rrugëve, përmirësimin e licensimit të ofruesve të kujdesit shëndetësor, testimin për hyrjen në universitet dhe mbikëqyrje më të fuqishme të institucioneve financiare (shih Aneksi 2 për më shumë detaje). Kjo u ritheksua më vonë dhe u shty më tej nga strategjia e Bankës Kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes së Vendit (CGAC) e vitit 2007. Tre leksionet kyçe të nxjerra nga implementimi i këtij filtri dhe nga programi i mëvonshëm CGAC janë (i) nevoja për të forcuar bazën analitike për përpjekjet në qeverisje; (ii) fokusim ndaj qasjeve dhe ndërhyrjeve të cilat janë më të prekshme për zyrtarët e Qeverisë (dhe gjithashtu ekipet zbatuese), p.sh. më shumë sinergji me aktivitetet dhe reformat ekzistuese të mbështetura nga Banka; dhe (iii) krijimi i një hapësire për ndërhyrje më të vogla, që ndodhin më shumë në momentin e duhur sipas mundësive që krijohen.

Këto leksione u inkorporuan në propozimin e Shqipërisë për një alokim ‘Window 1’ nga Faciliteti i ri i Bankës për Partneritet në Qeverisje (i përshkruar më poshtë në Kutinë 3) dhe kanë ndihmuar në rafinimin e fokusit të Filtrit të Qeverisjes për SPV e re. Propozimi i Shqipërisë ishte i konsiderueshëm duke qenë se qasja për të përmirësuar qeverisjen është në thelb është diçka që ka të bëjë me punën përgjatë portofolit në një përpjekje jo vetëm për të përmirësuar implementimin e projekteve të financuara nga Banka, por për të pasur një efekt të gjerë në ndryshimin e sistemeve qeverisës në të cilët këto projekte bashkëngjiten. Qasja e

³ Shtyllat e Qeverisjes ishin (i) transparencë më e madhe për shpenzimet publike; (ii) depolitizim i administratës publike dhe forcim i agjencive të pavarura; (iii) përcaktim dhe kuptim i sfidave të qeverisjes lokale; dhe (iv) pjesëmarrje më e lartë e qytetarëve në mekanizmat e mirë qeverisjes.

rishikuar kërkon të kapitalizojë potencialin e projekteve të bankës për të shtuar efektivitetin e enteve qeverisëse duke ofruar ekspertizë për shpenzimet dhe çështjet administrative, si një akt komplementar ndaj reformave dhe investimeve sektoriale. Filtri specifikon kërkesat për programet e huadhënies që lidhen me: (i) menaxhimin e shpenzimeve publike; (ii) marrëveshjet administrative; (iii) përdorimin, apo përdorimin e pjesshëm të disa sistemeve qeveritare të mirëbesimit; dhe (iv) informimin publik dhe përfshirjen e shoqërisë civile.

Së pari, *projekt duhet të jetë i integruar plotësisht në Programin e Buxhetit Afatmesëm të Qeverisë dhe përgatitja për projektet e rinj do të detyrojë grupet që të ndërmarrin analiza të shpenzimeve publike për shpenzimet e qeverisë në sektorët apo ministritë kyç.* Projektet duhet të demonstrojnë se si i përgjigjen të paktën njëres prej sfidave kryesore të politikave të shpenzimeve për atë sektor. Gjatë mbikëqyrjes, grupet e projektit do të kërkojnë të monitorojnë periodikisht implementimin e buxhetit të përgjithshëm për të gjithë sektorin dhe të performancës për sfidën e identifikuar të politikës në shpenzimet publike së bashku me ministrinë e linjës. Grupet e Sektorit duhet të lidhen dhe bashkëpunojnë nga afër me kolegët Rrjetin për Zvogëlimin e Varfërisë dhe Menaxhimin Ekonomik (PREM) për t'ia ushqyer këtë informacion dialogut të Bankës mbi politikën e menaxhimit fiskal dhe shpenzimeve publike. Mbi të gjitha, një integrim i tillë i përgatitjes dhe mbikëqyrjes së projektit në proceset buxhetore të qeverisë do të ndihmojë për mbështetje, me kalimin e kohës, të alokimit të resurseve bazuar më gjerë tek evidencat dhe për rritjen e transparencës për shpenzimet publike.

Së dyti, *çdo projekt i ri duhet të ndërmarrë një proces të shkurtër rishikimi si pjesë e marrëveshjeve të planifikuara të implementimit të “qendëruar”.* Kjo kërkesë i përgjigjet leksioneve të nxjerra gjatë SPV të shkuar. Këto rishikime do të ndihmojnë për të identifikuar më mirë pengesat potenciale në implementimin e projektit si dhe të qëllimeve të tjera për ndërtimin e kapaciteteve që mund të adresohen nga projekti, përmes qendërimit. Qeveria ka filluar tashmë një proces të vendosjes në radhë të përgjegjësive për menaxhimin e projekteve të financuara nga donatorët në secilën nga ministritë e linjës brenda një departamenti të vetëm. Banka do të mbështesë gjithashtu zhvillimin e marrëveshjeve të reja, përmes projekteve, sa herë kjo është e mundur.

Kutia 1: Qeverisja Vendore e Shqipërisë dhe Granti i Facilitetit për Programin e Partneritetit me Qeverisjen

*1.5 milion US\$ fonde nga DFID, Holanda, dhe Norvegjia
Mars 2009-Prill 2012*

1. Diagnostifikimi i Qeverisjes (studime mikro dhe makro mbi qeverisjen) – *i përfunduar*

- *Vlerësimi i Qeverisjes për Vendin*
- *Përgjegjshmëria në sektorët e Arsimit dhe Shëndetësisë*

2. Forcimi i Sistemeve të Vendit

- *Plani i Projekteve të Mirëbesimit:*

- *Vlerësim i Portofolit të Mirëbesimit për vendin – i përfunduar*
- *Sistemi i monitorimit të prokurimeve për portofolin e Bankës;*
- *Ndërtimi i kapaciteteve për palët e tjera dhe seminare për biznesin lokal të ofertave për kontratat e financuara nga Banka;*
- *Kontrata model prokurimi specialist me performancë të zgjeruar dhe përgjegjshmëri për ndërtimin e kapaciteteve;*
- *Përgatitje për udhëzuesin e taksave mbi kontratat e financuara nga donatorët dhe të ekzekutuara nga qeveria*
- *Asistencë teknike për vendosjen e mekanizmave të ankesave sipas kërkesave të BE për*

prokurimet dhe koncesionet publike

- Mbështetje për zgjerimin e sistemit të prokurimeve elektronike të qeverisë

• *Vlerësim mbi masat Mbrojtëse* të kuadrit ligjor për blerjen e tokës dhe implementimin e praktikave për masat mbrojtëse për shpronësimet

- Strategjia elektronike e Qeverisë dhe asistencë teknike mbi këtë çështje

3. Krijimi i Kërkesës për mirëqeverisje dhe përgjegjshmëri

- Fondi për Organizatat e Shoqërisë Civile (OJQ) Përfshirje në Mbikëqyrjen e portofolit të Bankës
- Panairi Shqiptar i Ideve dhe Projekteve për Mirëqeverisjen (me Këshillin Britanik)

4. Ndërhyrje të Vogla në kohën e duhur në Qeverisjen Sektoriale

- Studim i qeverisjes në sektorin e vogël të minierave (komplementues për

EITI)

- Asistencë teknike për rishikimin projekt legjislativ detyësor për Ligjin e Planifikimit Territorial
- *Aktivitetet e tjera, për t'u vendosur*

Kërkesa e tretë lidhet me *përdorimin, apo përdorimin e pjesshëm të menaxhimit të sistemit prokurimeve dhe/apo sistemeve të tjera financiar të vendit që janë aprovuar nga Menaxhimi Rajonal për Prokurimet dhe Financiar i Bankës*. Shqipëria ka bërë progres për sa i përket reformave në prokurimet publike dhe menaxhimin financiar. Të dy këto sisteme mirëbesimi vazhdojnë të marrin mbështetjen e IPS MDTF dhe GPF Planit të Veprimit për Mirëbesimin. Posaçërisht, Banka është në procesin e auditimit të sistemit Shqiptar të prokurimeve elektronike, çka do të nxjerr në pah përmirësimet e kërkuara për certifikimin nga ana e Bankës dhe IFI të tjerë për sistemin. Sistemi i automatizuar i Thesarit dhe zhvillimi i Sistemit të Informimit për Asistencën e Jashtme gjithashtu përfaqësojnë mundësinë për integrimin e plotë të financimeve të Bankës në sistemet e menaxhimit financiar të Qeverisë. Banka do të vazhdojë këtë mbështetje në mënyrë që gjithmonë e më shumë projekte të lëvizin drejt përdorimit të prokurimeve elektronike dhe sistemeve të Thesarit.

Së katërti, si një suplement për Politikën e re të Bankës për Akses ndaj Informacionit, *projekte ekzistues dhe projekte të reja do të nevojitet të zbulojnë mekanizma për përfshirjen e shoqërisë civile në mbikëqyrjen dhe monitorimin e implementimit*. Një program pilot për të tillë mekanizma mbështetet nga CGAC-GPF.

Rezultatet e pritura nga përdorimi i Filtrave të Qeverisjes v2.0 në portofolin e Shqipërisë lidhen kryesisht me efektivitetin e qeverisjes më shumë se sa me anti-korrupsionin, 'per se'. Një rezultat kyç do të ishte përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe menaxhimit financiar në qeverisjen qendrore, siç evidentohet dhe nga një përmirësim gradual i indikatorëve PEFA, veçanërisht i atyre që lidhen me monitorimin dhe raportimin e ekzekutimit të buxhetit dhe financimit të donatorëve. Një rezultat i dytë lidhet me implementimin e Deklaratës së Parisit mbi efektivitetin e zhvillimit, në veçanti me një ulje të numrit të njësisve të lira të implementimit të projekteve dhe me një përdorim më të madh të sistemeve të akredituara të mirëbesimit të vendit, të cilat monitorohen nga autoritetet Shqiptare në Studimin e çdo dy vjetëve për Deklaratën e Parisit. Rezultati përfundimtar i Filtrit të Qeverisjes v2.0 lidhet me përmirësimin e transparencës për punët e Bankës me qeverinë (jo vetëm të rezultateve të projekteve), siç evidentohet nga një përmirësim i indikatorëve relevant në Studimin periodik të Klientit nga Banka për Shqipërinë.

Programi i Financimit SPV

Huat e reja BNRZH për Shqipërinë gjatë periudhës së SPV priten të arrijnë rreth 275 milion USD, sipas kapacitetit financiar të BNRZH. Programi i financimit të Bankës përbëhet nga:

- (i) përfundimi i **15 projekteve ekzistuese investimi dhe fondeve të mëdha mirëbesues nga disa donator**, dhe
- (ii) përgatitja e **8 projekteve të reja investimesh dhe e një serie huash vjetore për politika të zhvillimit.**

SPV planifikohet të përfshijë hua për politikën në nivelin e rreth 100 milion USD (apo rreth 25 milion USD për vit) por i duhet të qëndrojë fleksibël duke pasur parasysh paqëndrueshmërinë e politikave makroekonomike dhe potencialin për përkeqësimin e tronditjeve të jashtme ekonomike. Projektet e propozuara DPL janë planifikuar që të fokusohen në reformat sektoriale në shërbimet sociale gjatë in VF11, dhe në reforma më të gjera që mbështesin rritjen dhe konkurrueshmërinë gjatë VF12-VF14. Gjithsesi, shumica e huas për mbështetjen e buxhetit do të jetë detyruesisht shumë e varur nga performanca makroekonomike e Shqipërisë dhe stabiliteti gjatë periudhës së SPV. Për shembull, huat DPL mund të reduktohen dhe më pas resurset e liruara të BNRZH mund të rialokohen për hua në investime në rast se qeveria dështon në kryerjen e rregullimeve të nevojshme fiskale për t'u kthyer në një trajektore më të ulët të borxhit gjatë periudhës së SPV. Në mënyrë të kundërt, Banka duhet gjithashtu të jetë e përgatitur për më shumë mbështetje DPL për Shqipërinë nëse vendi goditet rëndë nga ngjarjet ekonomike të Euro-zonës, paçka menaxhimit të kënaqshëm makroekonomik. Veprimtaritë e planifikuara të investimeve, në këto rrethana ose do të shtyeshin apo të braktiseshin. Dhe së fundmi, paçka performancës makroekonomike, nivelet e huave të planifikuara mbështetëse do të jenë gjithashtu subjekt i kapacitetit financiar të BNRZH. Nëse ka nevojë për ndryshime domethënëse për huadhënien DPL si pasojë e këtyre apo faktorëve të tjerë alternativ, ato do të diskutohen me Menaxhimin dhe do t'i prezantohen Bordit gjatë progres raportit të SPV apo përmes memorandumeve të përshtatshme të strategjisë, së bashku me projektet e reja.

Në vartësi të konditave të tregut gjatë katër viteve të ardhshme, **IFC pret që të investojë rreth 120-150 milion \$ në sektorin privat në Shqipëri** dhe që të përdorë shërbimet e saj këshillimore për të siguruar financime private për mirëmbajtjen e rrugëve, furnizimin me ujë, menaxhimin e mbetjeve të ngurta, dhe energjinë e rinovueshme. Investimet e IFC në sektorin privat do të kanalizohen përmes financimit direkt në një vartësi projektesh që variojnë nga agrobiznesi në turizëm, miniera, energji dhe shitje me pakicë. Në sektorin financiar investimet do të varrojnë nga forcimi i kapitalizmit të bankave (aty ku është e nevojshme), financimi afatgjatë për MSMEs, tek energjia e rinovueshme dhe produktet me efikasitet energjetik.

Tabela 3: Programi i Propozuar Indikativ BNRZH sipas Vitit Fiskal

	VF11	US\$m
Shërbimet Sociale DPL		25
Furnizimi Bashkiak me Ujë		40
	VF11 Total	65
	VF 12	
Rritja Ekonomike DPL		25
Burimet Ujore dhe Vadiçja		40
Investimet në Asistencën Sociale		25
	VF12 Total	90
	VF13	
Rritja Ekonomike DPL		25

Mirëmbajtja & Siguria Rrugore	30
Shërbimet Mjedisore	10+
VF13 Total	65
VF14	
Rritja Ekonomike DPL	25
Shëndetësia	10+
Arsimi	10+
Reforma e Sektorit Publik	10+
VF14 Total	55
TOTAL	275

+ Numri dhe volumi i veprimtarive investuese për VF13-VF14 do të rishikohet gjatë Progres Raportit SPV dhe do të varet nga progresi për konsolidimin e portofolit si dhe nga kapaciteti financiar i BNRZH.

Programi i SPV për Njohurinë

Studimi i vitit 2010 i Klientit dhe procesi konsultues i SPV vunë re mbështetjen prej të gjithë palëve të interesuara për vazhdimësinë e kontributit të Bankës për dialog transparent dhe publik mbi politikat dhe sfidat e zhvillimit me të cilat përballet Shqipëria. Grupi i Bankës do të vazhdojë të mundësojë shërbime analitike dhe këshillimore për të ndihmuar Shqipërinë që të përballet me sfidat gjatë viteve të ardhshme, por edhe për të siguruar një pjesëmarrje më të madhe publike gjatë diskutimit për këto sfida. Memorandumi Ekonomik për Vendin i përfunduar sëfundmi, Vlerësimi i Klimës e Investimeve, Vlerësimi i Qeverisjes për Vendin do të shpërndahen plotësisht gjatë VF11, dhe më pas do të ndiqen nga një seri rivlerësimi ekonomik tremujor që synon të hap debat mbi politikat makroekonomike. Banka gjithashtu do të vazhdojë serinë dyvjeçare të Konferencave lokale të Bankës Shqiptare për Ekonominë e Zhvillimit (ABCDE), që filluan gjatë SPV së mëparshme, për të mundësuar një skenë periodike dhe neutrale për debate publike për këto dhe çështje të tjera.

Programet e njohurisë së Bankës dhe IFC gjithashtu ndihmojnë për të ecur përpara në procesin e integritit të Ballkanit Perëndimor. IFC do të vazhdojë implementimin e programit të saj kryesisht rajonal të shërbimeve këshillimore në Shqipëri. Këto shërbime synojnë, jo vetëm të forcojnë mjedisin e biznesit dhe kapacitetin e sektorit lokal privat për të konkurruar në një mënyrë më të integruar në tregjet Evropiane dhe ndërkombëtare, dhe që të arrihet progres në afrimin me BE për disa fusha, por që gjithashtu të ndihmojnë integrimin e mëtejshëm të Shqipërisë me vendet fqinje në rajon përmes ndarjes së eksperiencave në reforma. Nga ana e Bankës, Shqipëria do të përfitojë më shumë punë ekonomike dhe sektoriale rajonale. Veçanërisht, Banka ka një program të vazhdueshëm për punë rajonale për analizën e varfërisë dhe sektorin financiar që fokusohet tek prioritetet rajonale, dhe një fond rrotullues për punën sektoriale rajonale. Fokusi i fundit i këtij fondi ka qenë menaxhimi i rrugëve lokale dhe një vlerësim i sektorit hekurudhor sipas SEETO që hap rrugën për një marrëveshje të re rajonale, çështjet e energjisë që lidhen me ECSEE, ndikimi i ndryshimeve klimaterike në burimet rajonale ujore dhe, rishtazi, eksperiencat e përbashkëta dhe sfidat e politikave sociale. Fushat e ardhshme do të përcaktohen me lindjen e nevojave dhe sinergjive potenciale.

Monitorimi dhe Vlerësimi

SPV do të mbështetet tek një kombinim i mekanizmave ekzistues dhe atyre në zhvillim të monitorimit dhe vlerësimit. Së pari, Banka do të vazhdojë mbështetjen e saj të gjatë

programatike për monitorimin dhe analizimin e varfërisë në Shqipëri, ndërkohë që i kushton më tepër vëmendje monitorimit dhe analizimit të mosbarazive gjinore. Shqipëria ka një program të mirë vendosur sondazhesh të bazuar tek familjet dhe standardet e jetesës të cilat kryhen çdo tre vjet, dhe për të cilat Banka ka mundësuar mbështetje teknike. Në mënyrë të ngjashme, Banka do të zgjerojë programin e saj të rregullt të monitorimit makroekonomik për të përfshirë prodhimin e raporteve ekonomike të shkurtra tremujore për aq kohë sa Shqipëria mbetet në një marrëdhënie pa-program me FMN. Nevoja për këto raporte do të rivlerësohet gjatë kohës me rritjen e aksesit të tregut dhe informacionit për tregun. Së fundmi, Banka po mbështet zhvillimin Monitorimit dhe Vlerësimit (M&E) të Qeverisë nga ajo vetë për strategjinë kombëtare për zhvillim përmes IPS MDTF. Për sa i përket implementimit të programit, Banka do të vazhdojë të ndërmarrë rivlerësime të përbashkëta të portofolit me Qeverinë dhe përgatitjen e përbashkët të Progres Raportit SPV gjatë VF13.